



FAKLUTETI JURIDIK

MASTER KUSHTETUES ADMINISTRATIV

TEMA:

**GARANCITE KUSHTETUESE LIDHUR ME
MOSDISKRIMINIMIN E GRUAS DHE ROLI I SAJ NE SKENEN
POLITIKE KOSOVARE**

Kandidati:

Ritë ARIFI

Mentor i temës:

Prof.Asoc.Dr. Murat JASHARI

Abstrakt

Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje i kontribon proceseve pozitive transformuese për shoqëritë, siç janë ndryshimet e ligjeve, politikave, shërbimeve, institucioneve dhe normave shoqërore. Është e rëndësishme të sigurohet se do të dëgjohen zëri i grave për vendimet që merren apo prekin jetët e tyre, jetët e familjeve të tyre dhe komunitetit më gjërë. Këto vendime prekin gratë po aq sa edhe burrat. Prandaj, gratë duhet të përfshihen në vendimmarrje në çdo fushë dhe të kenë fuqi dhe numër të barabartë me burrat. Është përgjegjësi e qeverisë dhe e shoqërisë në përgjithësi të sigurojë që grave iu ofrohen mundësi për të marrë pjesë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe se institucionet përfaqësojnë një llojllojshmëri të njerëzve dhe komuniteteve që ato përfaqësojnë. Fokusimi ynë do të përfshijë fushën përfaqësimit të grave në politikë, se si sistemi politik e veçanërisht partitë politike i qasen përfaqësimit sa më të madh të grave në jetën politike dhe funksionimin e tyre në Kosovë. Ideja dhe dëshira erdhi nga arsyeja sepse konstituimi i një sistemi politik demokratik në vendin tonë ka vështirësitë, problemet dhe sfidat që grate kanë ja vlen të studiohen dhe analizohen nga çdo studiues, e sidomos nga ne të shkencave juridike. Prandaj qëllimi i këtij hulumtimi është që të analizojë nivelet e tanishme të pjesëmarrjes së grave në politikë dhe proceset vendimmarrëse në Kosovë. Këto tematika do të jenë pjesë e këtij punimi të diplomës ku synojmë të jemi sa më të mirë duke reflektuar me fakte dhe argumente në studimin që do të bëhet.